

VENDIM
Nr. 437, datë 8.6.2016

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 418, DATË 27.6.2012, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E MASËS SË SHPËRBLIMIT TË ANËTARËVE TË KËSHILLAVE, BORDEVE OSE KOMISIONEVE TË NJËSIVE TË QEVERISJES QENDRORE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve", me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 418, datë 27.6.2012, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë vijon:

1. Pika 1 ndryshohet me këtë përmbajtje:

"1. Bordet, këshillat dhe komisionet e njësive të qeverisjes qendrore përbëhen nga përfaqësues të njësive të qeverisjes qendrore dhe nga përfaqësues të tjerë, sipas përcaktimeve të legjislationit përkatës. Përfaqësues i njësisë së qeverisjes qendrore, në këto organe, emërohet punonjësi organik i njësisë.

Punonjësit e emëruar me kohë të pjesshme në përbërje të bordeve, këshillave apo komisioneve të njësive të qeverisjes qendrore përfitojnë një pagesë për pjesëmarrjen dhe kontributin e tyre në këto organe, sipas përcaktimeve të këtij vendimi."

2. Në lidhjen nr. 1, të përmendur në pikën 3, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Në ndarjen "Magjistratura" shtohet nënndarja "Bordi i redaktorëve", sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

b) Në ndarjen "Ministria e Shëndetësisë" shtohet nënndarja "Bordi i edukimit të vazhdu-eshëm", sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

c) Në ndarjen "Ministria e Drejtësisë", masa e pagesës në nënndarjen "Këshilli Drejtues i Komitetit Shqiptar të Birësimeve" bëhet 10 000 (dhjetë mijë) lekë në muaj;

ç) Në ndarjen "Ministria e Financave" bëhen këto ndryshime:

i) Emërtesa "Komisioni i Kualifikimit për Certifikimin e Auditëve të Brendshëm në sektorin publik", bëhet "Komisioni i kualifikimit të audituesve të brendshëm";

ii) Emërtesa "Bordi i Menaxhimit për Kontrollin e Brendshëm Financiar" bëhet "Bordi i Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik" dhe numri i anëtarëve të bordit bëhet "7 anëtarë";

iii) Emërtesa "Komiteti i Auditimit të Brendshëm", shfuqizohet.

3. Pas shkronjës "d", të pikës 5, shtohet shkronja "dh" me këtë përmbajtje:

"dh. Masa e shpërblimit për anëtarin/kryetarin e Komitetit të Auditimit, që krijohet në njësinë publike, është 10 000 (dhjetë mijë) lekë për çdo mbledhje, por jo më shumë se 4 pagesa në vit."

4. Njësia e qeverisjes qendrore, që emëron përfaqësues të saj në bordet, këshillat dhe komisionet, cakton në një funksion/strukturë përgjegjëse me detyrën e mbajtjes së bazës së të dhënave të angazhimit të punonjësve në këto organe.

5. Efektet financiare, që krijohen nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i miratuar për institucionet e përmendura në këtë vendim.

6. Ngarkohen njësitë e qeverisjes qendrore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

TABELA

Institucioni buxhetor	Emërtesa e Bordit/ Këshillit /Komisionit	Numri maksimal i pagesave në një vit	Përbërja		Shpërblim kryetari (lekë)	Shpërblim anëtar (lekë)
			Kryetar	Nr. i anëtarëve		
Ministria e Shëndetësisë	Bordi i Edukimit të Vazhdueshëm	8	1	8	7 000	7 000
Shkolla e Magjistraturës	Bordi i redaktorëve	6	0	9	0	8 000